

URDHËR
Nr. 114, datë 23.10.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësim ligjor, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në proceset gjyqësore ku thirret si palë në gjykim, lëshohen për aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

3. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

4. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, gjatë seancës përkatëse të gjykimit, me përjashtim të akteve procedurale, të tilla si, por pa u kufizuar: kërkesëpadi, ankime, rekurse, kërkesa për pezullim ekzekutim vendimi.

5. Ky urdhër nuk cenon vlefshmërinë e autorizimeve të lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, për proceset gjyqësore në të cilat ky institucion ka qenë palë dhe që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe struktura përgjegjëse për çështjet gjyqësore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Arben Ahmetaj